



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 1312 Prot.

Tiranë, më 24.06 2026

V E N D I M Q A R K U L L U E S

Nr. 93 dt. 24.06 2026

**“PËR
MIRATIMIN E HAPJES SË PROGRAMIT TË PËRBASHKËT TË CIKLIT TË DYTË
“MASTER PROFESIONAL” NË “TRAJNIMI SPORTIV DHE TË USHQYERIT”, ME
DIPLOMË TË DYFISHTË, MIDIS UNIVERSITETIT TË SPORTEVE TË TIRANËS,
FAKULTETIT TË SHKENCAVE TË LËVIZJES DHE UNIVERSITETIT EVROPIAN
TË MADRIDIT”**

Mbështetur në nenin 3, 38 dhe 80 të Ligjit nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në IAL në Republikën e Shqipërisë”, Vendimin nr. 57 datë 29.01.2020 “Për dhënien e statusit të veçantë Universitetit të Sporteve të Tiranës”, Udhëzimin nr. 1, datë 14.1.2020 “Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësisive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë”, i ndryshuar, vendimin nr.310 datë 11.05.2022 “Për specifikimet dhe përmbajtjen e kodifikimit të programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, në nenin 7, 20, 73 të Statutit të UST-së, në nenin 7, 54 dhe 55 të Rregullores së UST-së, shkresën nr. 606/8 prot., datë 23.06.2026 të Fakultetit të Shkencave të Lëvizjes “Propozim për kodifikimin e programit të përbashkët të studimit të ciklit të dytë Master Profesional në “Trajnimi Sportiv dhe të Ushqyerit”, shkresën e Ministrisë së Arsimit nr. 4516 prot., datë 11.06.2026 “Njoftim mbi vlerësimin e aplikimeve”, Senati Akademik,

V E N D O S I :

1. Miratimin e hapjes së programit të përbashkët të ciklit të dytë Master Profesional në “Trajnimi Sportiv dhe të Ushqyerit”, me diplomë të dyfishtë, midis Universitetit të Sporteve të Tiranës, Fakultetit të Shkencave të Lëvizjes dhe Universitetit Evropian të Madridit.

2. Programi i përbashkët i studimit do të zhvillohet në gjuhën angleze.
3. Kodi i programit të përbashkët të studimit është P71MP1014A (shkresa bashkëlidhur).
4. Ky Vendim i përcillet për miratim Bordit të Administrimit
5. Ky Vendim i përcillet për njohje, zbatim dhe publikim Fakultetit të Shkencave të Lëvizjes të UST-së, si dhe Drejtorisë së Zhvillimit të Programeve e Digjitalizimit të Shërbimeve Akademiko-Shkencore.
6. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR I SENATIT AKADEMIK

Prof. Dr. Agron KASA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
FAKULTETI I SHKENCAVE TË LËVIZJES
DEKANI

Nr. 606/8 Prot.

Tiranë, më 23.06.2026

Lënda: Propozim për kodifikimin e programit të përbashkët të studimit të ciklit të dytë Master Profesional në “Trajnimi Sportiv dhe të Ushqyerit”

REKTORIT TË UNIVERSITETIT TË SPORTEVE TË TIRANËS
PROF.DR. AGRON KASA

I nderuar Z. Rektor!

Në vijim të shkresës Nr. 4516 Prot., datë 11.06.2026 të Ministrisë së Arsimit “*Noftim mbi vlerësimin e aplikimeve*”, Udhëzimit Nr. 31, datë 15.11.2022 “*Për procedurat për kodifikimin e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë*” të Ministrisë së Arsimit, si dhe Vendimit Nr. 310, datë 11.05.2022 “*Për specifikimet dhe përmbajtjen e kodifikimit të programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë*”, në tabelën e mëposhtme po ju përcjellim propozimin për kodifikimin e programit të përbashkët të studimit Master Profesional në “**Trajnimi Sportiv dhe të Ushqyerit**” që do të ofrohet nga Fakulteti i Shkencave të Lëvizjes në UST:

FAKULTETI I VEPRIMTARISË FIZIKE DHE REKRAECIONIT					
Nr.	Programi i studimit	Fusha e studimit	Kredite	Kohëzgjatja në vite	Kodi i programit
1	Cikli i dytë “Master Profesional”	Trajnimi Sportiv dhe të Ushqyerit	60	1 vit	P71MP1014A

Shënime:

- Në përputhje me pikën 4 të Vendimit Nr. 310, datë 11.05.2022, për programet e përbashkëta të studimit, kodi i programit paraprihet nga shkronja “P”.
- Në përputhje me Shtojcën Nr. 2 të Vendimit Nr. 310, datë 11.05.2022, gërma “A” në fund të kodit identifikon gjuhën e zhvillimit të programit, konkretisht gjuhën angleze.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin!

DEKANI

Prof.Asc.Dr. Enkeleida ELESHI